

Informacione te pergjitheshme

"GJOKA + A" Sh.p.k Dures . Rregjistruar në QKR Tirane me 20.06.2002.

NIPT: K31825504T

Shoqëria ka nje ortak.

Kapitali themeltar 95,000,000 Leke, i zotëruar nga nje ortak.

Selia e shoqërisë ndodhet ne Sallmone Shijak, Durres.

Objekti i veprimtarisë per ushtrimin 2019 është: *Sigurimi i objekteve publike dhe private, sigurimi i shtetasve, shoqerimi i vlerave monetare dhe i sendeve mevlere. Projektim, ndertim dhe zbatim i objekteve civile, ekonomike, social kulturore, shtetore e private. Projekte te PMNZSH dhe akte ekspertimi ne kete fushe. Rikonstrukcione te objekteve te ndryshme, Ndertim dhe asfaltim rrugesh. Instalimin e mjeteve të sistemit vrojtues, sinjalizues, audioviziv, radio alarm, mjeteve të mbrojtjes kundra zjarrit, pajisjeve të ndërlidhjes të teknikave të tjera të lejuara nga legjislacioni si dhe projektimin, instalimin dhe programimin e pajisjeve të telekomunikacionit, radiokomunikacionit dhe sistemeve të kontrollit dhe monitorimit në distancë të automjeteve si dhe tregtimin dhe instalimin emjeteve të mbrojtjes kundra zjarrit..*

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet me:

Statutin

Ligji 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

Ligji 7661 dt 19.01.1993 "Për Kontabilitetin" ndryshuar me Ligjin 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" (ndryshuar me Ligjin Nr.9477, date 09.02.06)

Legjislacioni fiskal.

Ligje dhe akte të tjera ligjore e nënligjore të shtetit shqiptar në fuqi.

Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftueshme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.






Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2017 janë 1 euro = 121.77 leke dhe 1 dollar = 108.64 leke.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin perfaqson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2019 është 15 %.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet në faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet e afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndertesat dhe mbi bazën e vlerës së mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qendrueshme. Normat e përdorura janë në ndertesa 5 % të vlerës fillestare dhe për aktivet e tjera 20% e 25% të vlerës së mbetur.

Gjendjet e inventareve

Vlerësimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)



"GJOKA + A" SHPK DURRES
SHENËME PER PASQYRAT FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR ME 31.12.2019
(Te gjitha balancat jane ne leke)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute jane si me poshte:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2019		Gjendja ne 31.12.2018	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	Leke	9,909,600		7,793,187	-
Arka ne leke	Leke	33,553,059		30,255,735	
Shuma		43,462,659	0	38,048,923	x

Gjendjet e llogarive te likuiditeve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura ne monedhe te huaj, jane perkthyer ne leke duke perdorur kursin e kembimit te fundit te ushtrimit te bankes respektive.

Aktive te tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2017 deklarohen si vijon:

		Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Te drejta te Arketueshme			
Nga aktiviteti i shfrytezimit	411	43,096,338	40,801,599
Nga njesit ekonomike brenda grupit	455	71,803,756	71,803,756
Te tjera te srketueshme(hua e dhene)	467	11,756,977	11,756,977
Te tjera (tatim fitimi)	444	1,281,884	2,006,412
Shuma		127,938,955	126,368,745

Ne "Llogari / Te tjera te Arketueshme ne shumen 127,938,955 leke jane pasqyruar faturat e pa arketuara per shitje sherbimi qe shoqeria ka realizuar gjate vitit ushtrimor dhe te mbartura te pa arketuara. Per kete llogari shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo kliente.

Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit nuk ka:

		Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Inventari			
Lendë e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte		-	-
Produkte të gatshme		-	-
Mallra		-	-
Shuma		-	-

Pasqyron gjendjen e vlerave materiale te destinuara per per aktivitetin e sherbimit. Kjo baze materiale eshte perdorur gjate vitit 2019. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kosos se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar".

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM-te)



"GJOKA + A" SHPK DURRES
SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR ME 31.12.2019
(Te gjitha balancat jane ne leke)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

	Gjendjet dhe levizjet	Ndertime	Mjete transporti	Te tjera Instalime e paisje	Aktivet te tjera A.Materiale(paisje zyre)	Aktivet te tjera A.Materiale(informatike)	Totali
A	Kosto e AAM-ve me 01.01.2019	416,667	18,805,495	9,042,078	387,475	1,236,598	29,888,313
	Shtesat			1,193,655	-	9,250	1,202,905
	Pakesimet		-	-	-	-	-
	Kosto e AAM-ve 31.12.2019	416,667	18,805,495	10,235,733	387,475	1,245,848	30,674,551
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2019	265,433	5,860,139	4,316,157	314,183	907,238	11,663,150
	Amortizimi ushtrimit	7,562	2,589,071	1,200,594	14,658	83,068	3,894,953
	Amortizimi per daljet e AAM-ve		-	-	-	-	-
	Amortizimi i AAM-ve 31.12.2019	272,995	8,449,210	5,516,751	328,841	990,306	15,558,103
C	Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2019		-	-	-	-	-
	Shtesat		-	-	-	-	-
	Pakesimet		-	-	-	-	-
	Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2019		-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2019	151,234	12,945,356	4,725,921	73,292	329,360	18,225,163
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2019	143,672	10,356,285	4,718,982	58,634	255,542	15,533,115

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2019..Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SNK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale.(shih shenimin nr.2)Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 paraqiten si vijon:



"GJOKA + A" SHPK DURRES
SHENËME PER PASQYRAT FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR ME 31.12.2019
(Te gjitha balancat jane ne leke)

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
<i>Titujt e huamarrjes</i>		
<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	-	-
<i>Hua te tjera</i>	-	-
<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>	-	-
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	478,800.00	402,162.00
<i>Dëftesa të pagueshme</i>	-	-
<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit</i>	-	-
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve</i>	5,339,910.00	5,242,274.00
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore tapi</i>	75,335.00	60,320.00
<i>Të pagueshme ndajsigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	837,558.00	846,231.00
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore tatim fitimi</i>	-	-
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore tvsh</i>	1,009,966.00	976,337.00
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore qera</i>	1,500.00	1,500.00
<i>Te tjera te pagushme(ortak)</i>	-	-
Shuma	7,743,069.00	7,528,824.00

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj te treteve per blerjet e bera gjate vitit te palikujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Detyrimet tatimore perfaqesojne ,tatimin mbi te ardhurat personale , sigurimet shoqerore dhe shendetesore te likujduara ne muajin Janar 2020 si dhe pagat e punonjesve.

Kapitalet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR.

Fitimi (humbja) e vitit financiar

Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit		
<i>Shitje Punime e Sherbime</i>	57,070,523	55,296,902
Shuma	57,070,523	55,296,902

Të ardhurat nga shitja e sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja. Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave dhe sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2019 jane treguar ne pasqyren perkatese.

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

"GJOKA + A" SHPK DURRES
SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR ME 31.12.2019
(Te gjitha balancat jane ne leke)

Te ardhura te tjera			
<i>Interesa te arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			3,418
<i>Te ardhura nga shitja e AQ.</i>		83,333	
Shuma		83,333	3,418
Shpenzime Financiare			
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>		(28,801)	(30,604)
Shuma		(28,801)	(30,604)

Shpenzime personeli

Numri mesatar i punonjesve gjate vitit 2019 eshte 96 punonjes. Jane bere rregullisht ndalesat per kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore si dhe te tatimit mbi te ardhurat nga punesimi.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2019 jane si vijon:

		Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT	4,802,182	2,719,290
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	-	-
1	Amortizime tej normave fiskale		-
2	Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor		-
3	Gjoha,penalitetete,demshperblime	-	-
4	Provizione qe nuk njihen		
5	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta		-
6	Te tjera-materiale jashte perdorimit(pa miratim)		-
7	Shpenzime te tjera	-	
III	PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)		-
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	4,802,182	2,719,290
V	Shpenzimi i tatim fitimit-15%	(724,528)	(410,898)
VI	FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	4,077,653	2,308,393

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

Finacieri

Senada Alla



Administratori

Ermir SHERA